



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 5 shkronja d) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar (me theks nën 14 paragrafi 8.1), si dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenit 19 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2025, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE/SHAVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE/SHAVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE EDUKATIVO ARSIMORE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë vendim formohet Komisioni Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës, sipas Kërkesës/Listës së DKA-së bashkëngjitur këtij vendimi, për Konkursin nr.prot.13-101/03-0023084/25 të datës 24.04.2025, në përbërjen si vijon:

1. **Blerim Vllasa**, zyrtar për arsimin e mesëm të lartë në Drejtorinë e Arsimit, kryesues
2. **Bahrie Talla**, drejtoresh në SHFMU "Hyzriu e Samiu" në fshatin Letanc, anëtare
3. _____ Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar/e, i/e cili/a caktohet nga kjo Ministri.

Neni 2

Komisioni përzgjedhës sipas këtij vendimi është Ad-Hoc. Mandati i tij përfundon me nxjerrjen e vendimeve përfundimtare për përzgjedhjen e kandidatëve në pozitat e kërkuara në Konkursin përkatës.

Neni 3

Komisioni punët dhe detyrat i kryen në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, si dhe dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse që rregullojnë këtë fushë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, si dhe Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.Prot. 01-020/04-0029234/25
Podujevë, datë, 28 maj 2025

